

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### Ndërmjet



**Prokurorisë së Përgjithshme  
të Republikës së Shqipërisë**

**Prokurorisë së Përgjithshme  
të Republikës së Azerbajxhanit**

Ky Memorandum Mirëkuptimi ("Memorandum") lidhet nga dhe ndërmjet Pjesëmarrësve të mëposhtëm:

Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit (këtu e në vijim do të referohen individualisht si "Pjesëmarrësi" dhe bashkarisht si "Pjesëmarrësit"),

Të bindur për rëndësinë e bashkëpunimit në punën e administrimit të drejtësisë,

Me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin ekzistues për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të përbashkëta në luftën kundër krimit ndërkombëtar, përfshi çështjet e rikuperimit të aseteve, si dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,

Kanë rënë dakord, si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi i Memorandumit**

Ky Memorandum ka për qëllim identifikimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet Pjesëmarrësve, si dhe planifikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të trajnimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të prokurorëve.

#### **Neni 2**

##### **Fushat e Bashkëpunimit**

2.1 Pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

2.2 Shkëmbimi i informacioneve për legjislacionet përkatëse, rregulloret dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë penale;

2.3 Shkëmbimi i ekspertizës nëpërmjet pjesëmarrjes së secilit Pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe trajnime të organizuara nga Pjesëmarrësi tjetër;

PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Vërtetohet nësia me  
originalin

2.4 Vizita studimore në institucionet përkatëse gjyqësore, për të marrë njohuri për sistemin gjyqësor të Pjesëmarrësit tjetër;

2.5 Shkëmbimi i botimeve shkencore, materialeve metodologjike për çështje me interes të përbashkët;

2.6 Shkëmbimi i materialeve ligjore dhe kërkimeve në lidhje me legjislacionet e të dy shteteve, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e sistemeve gjyqësore.

### **Neni 3**

#### **Ecuria e Zbatimit**

3.1 Për qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi, Pjesëmarrësit do të komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin. Çdo Palë cakton një koordinator për ta përfaqësuar atë për qëllime të ndjekjes së zbatimit të dispozitave të këtij Memorandumi, si më poshtë:

Nga pala shqiptare:

Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë

Departamenti i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë

Adresa: Prokuroria e Përgjithshme, Rr. "Qemal Stafa", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

E-mail: Foreign.Department@pp.gov.al

Web: www.pp.gov.al

Nga pala azerbajxhanase:

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Azerbajxhanit

Departamenti i Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar

Adresa: AZ1001, Rr. Nigar Rafibeyli. 7, Baku, Azerbajxhan

Faks: +99412 4920019

E-mail: international@prosecutor.gov.az

3.2 Pjesëmarrësit bien dakord të njoftojnë njëri-tjetrin në mënyrë të rregullt në rast të ndonjë ndryshimi në lidhje me kontaktet përkatëse.

### **Neni 4**

#### **Konfidencialiteti**

Pjesëmarrësit nuk mund t'i transferojnë një Pjesëmarrësi të tretë dokumentet e marra sipas këtij Memorandumi pa lejen me shkrim të Pjesëmarrësit që ka dhënë këtë informacion.

### **Neni 5**

#### **Shpenzimet**

Çdo pjesëmarrës do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi.

### **Neni 6**

#### **Detyrimet Ligjore**

Ky memorandum nuk është një traktat ndërkombëtar dhe nuk krijon asnjë të drejtë apo detyrim sipas ligjit ndërkombëtar.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Vërtetohet njësisht me  
originalin

**Neni 7**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Pjesëmarrësve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve ose negociatave ndërmjet Pjesëmarrësve.

**Neni 8**

**Ndryshimet**

Dispozitat e këtij Memorandumi ose ndonjë prej teksteve të tij mund të ndryshohen me miratim me shkrim ndërmjet pjesëmarrësve. Këto ndryshime do të jenë në një dokument të veçantë duke qenë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 9 të këtij Memorandumi.

**Neni 9**

**Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi**

9.1 Ky memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar kohe.

9.2 Secili Pjesëmarrës mund të njoftojë në çdo kohë synimin e tij për të anuluar këtë Memorandum drejtpërdrejt ose nëpërmjet kanaleve diplomatike. Anulimi do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së një njoftimi me shkrim nga Pjesëmarrësi. Anulimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në zbatimin e aktiviteteve për të cilat është rënë dakord para datës së anulimit, ose që janë duke vazhduar në datën e lartpërmendur.


9.3 Nënshkruar në Baku, më 1 tetor 2024, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, me të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

**Për Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë**

**Për Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit**

\_\_\_\_\_  
**Olsiari ÇELA**  
Prokurori i Përgjithshëm

\_\_\_\_\_  
**Kamran ALIYEV**  
Prokurori i Përgjithshëm



**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**  
Vërtetohet njësisht me origjinalin